



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	06.07.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedimca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtujca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHC	3950/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. Nr. 334/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga; Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr. 334/2019, të datës 17.06.2019, të ankuesit me adresë banimi rruga perfaqësuar përmes zyrës Juridike nga Komuna e Mitrovicës, sipas Aktgjykimit A nr.2361/2019, të datës 12.05.2022. të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative të pranuar në KPMSHC me datë 30.06.2022, kundër organit të punësimit "Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale" në çështjen juridike "kompensimi material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 06.07.2022, mori këtë;

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa me numër A. Nr. 334/2019 e datës 17.06.2019, e parashtruar nga ankuesi sipas Aktgjykimit A.nr. 2361/2019, të datës 12.05.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.
- II. **MBETET NË FUQI**, aktvendimi i datës 11.03.2019, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- III. **SHFUQIZOHET** vendimi i datës 07.05.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë se Punës dhe Mirëqenies Sociale.

A r s y e t i m

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me datë 11.03.2019, ka nxjerr vendim Nr.115 me të cilin vendim, ankuesi është njoftuar lidhur me Përfundimin e mardhënies së punës për shkak të moshës së pensionimit në kuadër të shërbimit civil të Kosovës gjegjësisht Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e datës 11.03.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me datën 26.04.2019, me numër protokoll 148, ka parashtruar ankesë tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punës dhe Mosqenies Social.

Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me datën 07.05.2019, me numër protokoll 1538, ka nxjerr vendim me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar në ligj.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin datës 07.05.2019 të nxjerr nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në pajtim me Ligjit Nr. Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me datë 17.06.2019, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me kompensimin e tri pagave, pas arritjes së moshës së pensionimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesën e ankuesit e ka proceduar tek Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për përgjigje në ankesë me datë 25.06.2019, ndërsa me datën 02.07.2019 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me provat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.09.2019, me numër protokoll 4097/2019, ka njoftuar ankuesin se nuk mundë të shqyrton dhe vendose lidhur me ankesën A. Nr. 334/2019, të datës 17.06.2019, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar ankuesin që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, i pakënaqur me njoftimin e datës 03.09.2019, të Këshillit ka hapur konfliktin administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 12.05.2022, A. Nr. 2361/19, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 30.08.2019, duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A. Nr. 334/2019, të datës 17.06.2019 të ankuesit

Administrimi i Provave, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr.334/2019 e parashtruar më datë 17.06.2019, me numër protokoll 2752/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimit A.nr. 2361/2019, të datës 12.05.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative; Vendimi i datës 07.05.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 11.03.2019; Kërkesa për pagesë retroaktive e datës 26.04.2019; Ankesa e datës 26.04.2019, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve; Njoftimi i datës 03.09.2019, me numër protokoll 4097/2019, i Këshillit; Përgjigja në ankesë e datës 02.07.2019, me shkresat e bashkangjitura;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar Aktgjykimin e datës 12.05.2022, A. Nr.2361/19, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative me të cilin aktgjykim e ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin e datës 03.09.2019, të Këshillit, me të cilin aktgjykim Këshillin e ka obliguar që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A. Nr. 334/2019, të datës 17.06.2019 të ankuesit

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon së organi i punësimit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, duhet të bëjë pagesën në vlerën e tri (3) pagave me rastin pensionimit, sipas kontratës kolektive

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Sekretari Përgjithshëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me datën 11.03.2019, ka nxjerr vendim me të cilin i është përfunduar marrëdhënia e punës nëpunësit civil me të cilin i ka njohur të drejtën e një pagë pas arritjes se moshës së pensionimit, ndërsa ankuesi ankesën e ka parashtruar me datën, 26.04.2019, me numër protokoll 148, të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave tek Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e që është jashtë afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh të përcaktuar me dispozitat e nenit 127, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ*", si dhe në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes se Kontesteve dhe Ankesave ku thuhet se *Ankesa duhet te paraqitet brenda afatit prej (30) ditësh kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tije nga marrëdhënia e punës, prandaj për këtë arsye Kolegji ka vendosur që ta shfuqizoj Vendimin e KZAK Nr.1538*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë se Punës dhe Mirëqenies Sociale, ne rastin e nxjerrjes se Vendimin e datës 07.05.2019, me numër protokoll 1538, ka vepruar në kundërshtim me nenin 52, paragrafi

1, nën paragrafi 1.1,1.2,1.3,1.4,1.5,1.6 dhe 1.7, të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, sipas vendimit të datës 11.03.2019, ankuesit i ka njohur të drejtën e një pagë pas arritjes së moshës së pensionimit, duke vepruar në pajtim me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafit 2.2 Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton se: Paragrafi 1. "Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit" dhe paragrafi 2. "Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit".

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit lidhur pagesën në vlerën e tri (3) pagave me rastin pensionimit, sipas marrëveshjes së përgjithshme kolektive, kolegji konstaton se në bazë nenin 82 të kontratës Kolektive të përgjithshme, kontrata ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet", mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, paragrafi 1 ka përcaktuar që: "Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës", bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: "Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit", mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes, dhe mbi bazë të kësaj kolegji konstaton, marrëdhënia e punës ankuesit

i ka përfunduar për shkak të arritjes së moshës së pensionimit në vitin 2019, sipas vendimit me numër 115/2019 të datës 11.03.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, përkatësisht në kohen kur nuk ka qenë në fuqi marrëveshje e përgjithshme kolektive, andaj kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr.334/2019

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit;
- Avukatit
- Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Arkivit të KPMSHCK-së